

shpallur me 22.06.2020
përzemërisht me 07.07.2020



Në bazë të nenit 113 paragrafit 1 dhe 3 të Ligjit mbi vetëqeverisjes lokale ("Fleta Zyrtare e MZ", nr. 02/18, 34/19 dhe 038/20), e në lidhje me nenin 7 të Vendimit mbi organizimin mbi mënyrën e punës së administratës lokale të Komunës së Tuzit ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale", nr. 026/19, 030/19) dhe Vendimit mbi fillimin e procedurave për plotësimin e vendit të punës, numër 01-031/20-5732 prej më 17.06.2020, Sekretariati për vetëqeverisje lokale - Zyra për burimet njerëzore, shpall:

KONKURS PUBLIK

për nevojat e Shërbimit të kryetarit të Komunës së Tuzit

1. Nëpunësi/sja për punë të përgjithshme- Kabineti i krytarit

- Ekzekutues: 2, në kohë të pacaktuar;
- 12 nivel të kualifikimit shkollor;
- Pa pervojë pune.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- formulari i paraqitjes për vendin e lire të punës (Formularin e paraqitjes për vendin e lirë të punës kandidatët mund ta nxjerrin në web faqen e Komunës së Tuzit www.tuzi.org.me ose drejtpërdrejt në arkivin e Komunës së Tuzit),
- Curriculum Vitae – CV,
- fotokopja e letërnjoftimit biometrik,
- diplomë ose vërtetim mbi përfundimin e nivelit dhe llojit të arsimit
- vërtetimin e gjyqit kompetent se kundër kandidatit se nuk zhvillohet procedure penale sipas detyrës zyrtare.

Periodha e provës në punë është e obligueshme për zyrtarin shtetërorë, , gjegjësisht nëpunësi i cili për herë të parë lidh marrëdhënie pune në kohëzgjatje të pacaktuar në organin shtetërorë. Periodha e provës zgjatë një vit.

Kandidatët mund tia dorëzojnë kopjen e dokumentacionit të lartpërmendur Zyrës për burimet njerëzore (Në tekstin e mëtejme, Zyrës), përderisa origjinalin janë të obliguar tia japin në shikim zyrtarit të autorizuar të Zyrës për realizimin e shpalljes.

Me organin shtetëror nuk mund të lidh vend pune personi i cili është përdorues i të drejtës në pension, në pajtim me ligjin.

Zyrtari shtetëror, gjegjësisht nëpunësi i cili e ka realizuar të drejtën në paketën për shkurtim nga puna nuk mund të lidhin vendin e punës në organin shtetëror ose personin juridik, në periudhën prej një viti nga dita e pagesës së paketës për shkurtim nga puna. Kufizimi nuk vlen për personin i cili e kthen shumën totale të paketës për shkurtimin e punës që ka pranuar.

Verifikimi i dijes, aftësisë, kompetencave dhe shkathtësive, varësisht prej kategorisë së vendit të punës do të bëhet në pajtim me nenin 115 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale ("Fleta Zyrtare e MZ", numër 02/18, 34/19 dhe 038/20), si dhe në bazë të nenit 17 të Regullores mbi kriteret dhe mënyrën e hollësishme për verifikimin e dijes, aftësive, kompetencave dhe shkathtësive për punë në organet shtetërore ("Fleta Zyrtare e MZ", numër 050/18).

Mbi datën, vendin, dhe mënyrën e verifikimit, të kandidatëve nga lista, kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e shpalljes publike do të jenë të njoftuar përmes ueb faqes së Komunës së Tuzit, më së largu pesë ditë para ditës së verifikimit.

Dokumentacioni i kërkuar është i nevojshëm të dorëzohet në afat prej 15 ditëve nga dita e shpalljes së konkursit publik në zarf të mbyllur (në të cilin është e nevojshme të shkruhet: emri dhe mbiemri, adresa, kontakt telefoni, emri i organit dhe vendi i punës) në adresën:

Komuna e Tuzit
Sekretariati për vetëqeverisje lokale - Zyra për burime njerëzore
Me shënim: për Konkurs publik për nevoja të Shërbimit të kryetarit të Komunës së Tuzit

Kontakt tel: +38220875167;

SEKRETARE,
Marina Ujkaj

